**AKT THEMELIMI**

**"TREVO" SHPK**

**1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë.**

Emri i shoqërisë do të jetë **"TREVO" SHPK**, nga këtu e më poshtë referuar edhe si "shoqëria". "TREVO" themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

**2. Ortaku i vetëm i shoqërisë.**

Ortak i Vetëm i shoqërisë është: **z. Ardit Celibashi,** shtetas Shqiptar, i datëlindjes 24.03.1983, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, i identifikuar nga karta e identitetit me nr. 033448847 dhe nr. personal I30324054A.

**3. Objekti i veprimtarisë.**

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

- **Ndertimi, rikonstruksioni, rinovimi, riparimi i objekteve te ndryshme industriale, transportit, bujqesise, objekteve ushtrarake ,turizmit, detare, te banimit etj ku perfshihen: ndertimi i stabilimenteve dhe/ose komplekseve te ndryshme industriale, panele diellore, parqe fotovoltaike , bujqesore dhe te sherbimit, me konstruksion dhe perberje ndertimore hekur, beton, xham, druri etj.**
- **Investim ne te gjitha fushat e biznesit.**
- **Prodhim materialesh inerte dhe tregtimi i tyre.**
- **Ndertimi dhe riparimi i rrugeve te kategorive te ndryshme, urave, sistemeve te ujesjellesave dhe te kanalizimeve te ujrave te zeza, sistemeve te vaditjes, transportimit te enegjise elektrike, dhe lendeve te tjera djegese.**
- **Instalimi dhe riparimi i impanteve industriale, te ngrohje-ftohje, hidrosanitare, higjenike, elektrike.**
- **Tregtim dhe shitje me shumice e pakice e materialeve te ndertimit, qeramike dhe hidrosanitare, ushqimore , kozmetike,tekstile, pesticide , plehra kimike bujqesore dhe blegtorale, si dhe import- eksport i tyre .**

- **Tregti te pajisjeve elektronike, kompjutera, aksesore, kancelari, mobilieri. Ndermjetesim per blerje, shitje e dhenie me qira te pasurive te paluajtshme. Sherbime mirembajtje dhe servisi te ndryshem per materialet e pajisjeve elektrike dhe industriale.**
- **Sherbime konsulence, trajnime profesionale ne fushen e ndertimit , mjedisit, si edhe te financave dhe kontabilitetit.**
- **Ekspertiza Teknike Topografike, Rilevime topografike, etj.**
- **Ne përputhje me legjislacionin Shqiptar, Shoqëria mund te kryeje te gjitha ato aktivitete te cilat lidhen ne mënyrë te drejtpërdrejtë apo te tërthortë apo qe rezultojnë te nevojshme për realizimin e qëllimeve te mësipërme.**

Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

**4. Selia e shoqërisë.**

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Njësia Farkë, Mjull-Bathore, Rruga «Kabet» 03910060, Nd. 4, Kodi postar 1045, Tiranë, Shqipëri.**

- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

**5. Kohëzgjatja e shoqërisë.**

Afati i veprimtarise se Shoqerise eshte **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**6. Kapitali themeltar.**

- Kapitali themeltar i shoqerise eshte **1,000 (nje mije) leke.**

- Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale **1,000 (një mijë) lekë** dhe zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

**7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë.**

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

**8. Administratori.**

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.

- Administrator i parë i shoqërisë është: **z. Ardit Celibashi, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 24.03.1983, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, i identifikuar nga karta e identitetit me nr. 033448847 dhe nr. personal I30324054A.**

**9. Likuidimi i shoqërisë.**

Në rast falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

<u>**ORTAKU I VETËM**</u>

**Ardit CELIBASHI**

Ardit Celibashi

**Datë 27.03.2024**